

**VENDIM**  
**Nr.360, datë 13.5.2011**

**PËR KOMPENSIMIN E VLERËS SË TAKSËS SË BIZNESIT TË VOGËL, TË PËRDORUR**  
**PËR RIMBURSIMIN E PAJISJEVE FISKALE E TË TAKSIMETRAVE,**  
**PËR 21 BASHKI DHE 25 KOMUNA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e vlerës së pajisjeve fiskale dhe taksimetrave, për njësitë e qeverisjes vendore, për 21 bashki dhe 25 komuna, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ky fond, në vlerë 416 592 351 (katërqind e gjashtëmbëdhjetë milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e treqind e pesëdhjetë e një) lekë, të përballohet nga Fondi i Kontigjencës i miratuar në buxhetin e vitit 2011.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**